



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Dragash
Opština Dragaš
Municipality Dragas

- Kuvendi Komunal
01 Nr.06-6355/3
Dt.28.04.2016
D r a g a s h

Në bazë të nenit 13. dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 2.3. dhe 4 të Ligjit për Eksproprium e Pronës së Paluajtëshme (Ligji nr.03/L-139, dhe neneve 32.2. dhe 57 të Statutit të Komunës Dragash, si dhe Kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal II nr.464-585 të dt. 08.04.2016, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seacën e mbajtur të dt.:28.04.2016, miraton këtë:

V E N D I M

I .LEJOHET shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për eksproprium për qëllime të interesit publik të pronave të paluajtëshme private për nevojat e Komunës së Dragashit me qëllim të ndërtimit, zgjerimit dhe krijimit të rrugëve komunale për ofrimin e shërbimeve të trafikut publik në trasen (pjesën) nga Krusheva-Pika Kufitare Shishtavec (Shqipëri) L-3,3 km. sipas Shkresës së MAPL-së dhe Tabelës në shtojcë të këtij Vendimi.

II. Vlerësimi i pronës do të bëhet nga ana e Shërbimit Pronëso- Juridik të Komunës së Dragashit në harmoni me nenin 15 të Ligjit të larpërmendur dhe Udhëzimit Administrativ MF-Nr.02/2015 për lejimin e e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për llogaritje të shumës së kompensimit për pronë të paluajtëshme e cila është objekt e ekspropriumit dhe dëmeve që i përkasin ekspropriumit.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Shërbimi Pronëso- Juridik (DUGJMM) dhe Drejtorati i Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural dhe Inspektionit i Komunës-Dragash.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së dhe publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës-Dragash.

Shtojcë: Shkresa e MAPL-së dhe Tabela e ekspropriumit...

I dërgohet:

- MAPL-së (Zyrës Ligjore)-Prishtinë,
- Kryetarit të Komunës së Dragashit,
- Drejtoratit të Urbanizimit, Gjeodezisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit-Dragash,
- Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Inspektion-Dragash, dhe
- Arkivit



Kuvendi Komunal-Dragash
Kryesuesi
Shaban Shabani